

Masat e pakos emergjente

Masat e listuara përfshijnë grupet:
pensionale dhe sociale, punëdhënësit,
vetë-punësuarit, punëtorët, të pa
punët, OJQ-të me projekte për
komunitete jo-shumicë.

MASA
1

MASA
2

MASA
3

MASA
7

MASA
8

MASA
9

MASA
10

MASA
14


MASA
15



Përmbajtja

MASA 1	- Jeni përfitues i skemave sociale?	04
MASA 2	- Jeni përfitues i skemave sociale dhe pensionale me pagesë mujore deri në 100€?	05
MASA 3	- Jeni punëdhënës në vështirësi financiare?	06
MASA 7	- Jeni punëtor i dyqaneve ushqimore, furrave, ose barnatoreve?	08
MASA 8	- Jeni punëtor që ka humbur vendin e punës?	09
MASA 9	- Keni iniciativë dhe projekt që synon përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës?	10
MASA 10	- Jeni mikro-ndërmarrje ose i vetë-punësuar?	11
MASA 14	- Jeni punëtor pa kontratë pune?	12
MASA 15	- Jeni i regjistruar si i papunë?	13

Jeni përfitues i skemave sociale?



Përfito nga



E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

Shumën e dyfishtë të asistencës sociale të zakonshme

Kush përfiton?

- Të gjithë përfituesit e **skemave sociale për muajin Prill dhe Maj**

Si të aplikoj?

- Përfituesit **nuk kanë** nevojë të aplikojnë. Kjo masë realizohet me automatizëm në bazë të listave ekzistuese të përfituesve të skemave sociale

Jeni përfitues i skemave sociale dhe pensionale me pagesë mujore deri në 100€?



Përfito nga

MASA
2

E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Shtesën **30€** më shumë se asistenca sociale apo pensioni i zakonshëm

Kush përfiton?

- Të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë **deri në 100€** për muajin Prill, Maj, dhe Qershor
o Kusht: Përfituesi duhet të jetë përfitues i VETËM një skeme

Si të aplikoj?

- Për pagesën shtesë, përfituesit **nuk kanë** nevojë të aplikojnë. Kjo masë realizohet me automatizëm në basë të listave ekzistuese të përfituesve të këtyre skemave.
- Përfituesit që për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën Janar-Mars 2020 nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre, do të rikthehen përkohësisht në listën e përfituesve nga Departamenti i Pensioneve dhe Divizioni i Ndhimave Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Jeni punëdhënës në vështirësi financiare?




Përfito nga



E PAKOS FISKALE EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Mbulimin e shpenzimeve të **pagave mujore të punëtorëve** (dhe të vetë-punësuarit për bizneset individuale) në vlerë prej **170€** për pagat e muajit Mars dhe Prill. Pagesa bëhet në muajt Prill dhe Maj
 - o Në rast se punëdhënësi ka kryer pagat e muajit Mars 2020 në tërësi edhe pse me vështirësi financiare, pagesa prej **170€** për punëtorët do të kreditohet në llogarinë e punëdhënësit si rimbursim i shpenzimeve. Paga e muajit Prill kreditohet në llogarinë e punëmarrësit
- Subvencionimi i qirasë deri në **50% të vlerës së qirasë** për mikro-ndërmarrjet, **ndërmarrjet e vogla dhe të mesme** për muajin Prill dhe Maj
 - o Qiramarrësit të cilët kanë parapaguar qiranë vjetore nuk mund të përfitojnë
- Mbulimi i vlerës së **kontributeve pensionale për pagat** lidhur me masat e parapara për muajin Prill dhe Maj



Kush përfiton?

- Shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik
- Shoqëria tregtare nënkupton të gjithë punëdhënësit (siç janë organizatat jo qeveritare, bashkësitë fetare, dhe entitete të ngjashme)

Si të aplikoj?

Për mbulimi të pagave të punëtorëve

- Punëdhënësi duhet të plotësoj në sistemin elektronik EDI **formularin dhe listën** e dizajnuar nga ATK në www.atk-ks.org deri më **15 Maj 2020**
- Për plotësim të listës së punëtorëve, duhet bërë kategorizimi i statusit të punëtorëve ku në kolonën “Statusi” vendosen shkronjat përkatëse (A,B,C), ku në kategorinë A hyjnë punëtorët aktiv të cilët kompensohen me vlerë **170€**
- Punëdhënësi duhet të dëshmojë që veprimtaria e tij është ndikuar negativisht nga situata e emergjencës shëndetësore. Vërtetimi bëhet: (I) duke dëshmuar që vepron në njërin nga kodet e veprimtarive të cilave u është ndërprerë puna me urdhër të Qeverisë, ose (II) duke dëshmuar rënien e të hyrave të tyre për shkak të vendimeve të Qeverisë përmes librit të arkës, bilancit bankarë dhe dëshmi të tjera të ngjashme
- I punësuari mund të përfitojë vetëm nëse paga e dhënë nga punëdhënësi për periudhën Shkurt 2020 është e deklaruar si pagë primare
- I punësuari duhet të posedojë **llogari bankare valide** në një nga bankat në Kosovë
- Për udhëzime të detajuara për aplikim mund t'i kliko në:

[Kliko ketu](#)

Për të përfituar nga subvencionimi i qirasë

- Qiramarrësi duhet të plotësoj dhe ngarkoj **formularin dhe listën** e dizajnuar nga ATK www.atk-ks.org më se largu deri më **15 Maj 2020**
- Qiramarrësi duhet të ngarkojë kontratën e qirasë në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit e cila duhet të jetë e lidhur para datës **1 Mars 2020**
- Qiramarrësi duhet të deklaroj që veprimtaria e tij është ndikuar negativisht nga situata emergjente për shkak të vendimeve të Qeverisë. Vërtetimi bëhet: (I) duke dëshmuar që vepron në njërin nga kodet e veprimtarive të cilave u është ndërprerë puna me urdhër të Qeverisë, ose (II) duke dëshmuar rënien e të hyrave të tyre për shkak të vendimeve të Qeverisë përmes librit të arkës, bilancit bankarë dhe dëshmi të tjera të ngjashme
- Qiradhënësi duhet të posedojë **llogari bankare** në një nga bankat në Kosovë
- Për udhëzime të detajuara për aplikim kliko në:

[Kliko ketu](#)

Jeni punëtor i dyqaneve ushqimore, furrave, ose barnatoreve?



Përfito
nga



E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Pagesën shtesë me vlerë **100€** për muajin Mars dhe Prill

Kush përfiton?

- Punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave, dhe barnatoreve
o Kusht: Punëtori duhet të ketë kontakt të drejtpërdrejt me konsumatorin gjatë punës së bërë

Si të aplikoj?

- Punëdhënësi duhet të plotësoj kërkesën përmes në sistemin elektronik EDI **formularit** të dizajnuar nga ATK www.atk-ks.org
- Punëdhënësi duhet të plotësoj listën e punëtorëve (duke cekur edhe pozitën) të cilët kanë punuar gjatë muajit Mars dhe Prill së bashku me të dhënat e llogarisë bankare të secilit punëtor dëshmitë e deklarimit në ATK të këtyre punëtorëve për muajin Shkurt 2020.
- I punësuari duhet të posedojë **llogari bankare** në një nga bankat në Kosovë
- Për udhëzime të detajuara për kliko në:

[Kliko ketu](#)

Jeni punëtor që ka humbur vendin e punës?



Përfito nga



E PAKOS FISKALE EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Pagesë në vlerë **130€** për muajin Prill, Maj, dhe Qershor

Kush përfiton?

- Punëtorët të cilët humbin vendin e punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik
- Përfituesit nuk mund të jenë përfitues të skemave të tjera

Si të aplikoj?

- Ish punëtori duhet të jetë larguar nga puna si rezultat i rënies së aktivitetit të ndërmarrjes për shkak të situatës së pandemisë që dëshmohet me dokumentacion
 - o Ish Punëdhënësi duhet të plotësojë dhe ngarkojë në sistemin elektronik EDI formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK në www.atk-ks.org deri më **15 Maj 2020**
 - o Për plotësim të listës së punëtorëve, duhet bërë kategorizimi i statusit të punëtorëve ku në kolonën “Statusi” vendosen shkronjat përkatëse (A,B,C), ku në kategorinë B hyjnë punëtorët jo-aktiv të cilët kompensohen me vlerë **130€**
 - o Ish punëtori duhet të jetë pjesë e listës së pagave të dorëzuar nga punëdhënësi në Shkurt 2020
 - o Ish punëtori duhet të posedojë **ilogari bankare** valide në një nga bankat e Kosovës
- o Për udhëzime të detajuara për aplikim kliko në:

[Kliko ketu](#)

Keni iniciativë dhe projekt që synon përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës?

Përfito nga



E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Mbështetje financiare për realizim të iniciativës ose projektit

Kush përfiton?

- Organizatat që kanë projekte ose iniciativa që synojnë përmirësimin e komuniteteve jo shumicë të goditur rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik

Si të aplikoj?

- Organizatat duhet të aplikojnë me programe dhe projekte konkrete në Zyrën e Kryeministrit – Zyra për Komunitete deri me datë **15 Maj 2020**

Je i mikro-ndërmarrje ose i vetë-punësuar?



Përfito nga

MASA
10

E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Për mikro-ndërmarrjet dhe të vetëpunësuarit, sigurimi i garancionit për likuiditetin financiar (hua) përmes programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në shumë deri në **10,000€** për periudhën 24 muaj.
- Për shoqëritë Tregtare dhe Kompanitë e autorizuara që ofrojnë shërbime të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike, garanci nga FKGK deri në **50% të shumës së kredituar**, kurse nga Qeveria e Kosovës mbulim shtesë i garancisë deri në **30% të shumës së kredituar** mbi shumën e garantuar nga FKGK.

Kush përfiton?

- Mikro-ndërmarrjet (shoqëritë tregtare e cila ka deri në 10 të punësuar) dhe të vetë punësuarit.
- Shoqëritë Tregtare dhe Kompanitë e autorizuara që ofrojnë shërbime të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike.

Si të aplikoj?

- Mikro-ndërmarrjet dhe të vetëpunësuarit duhet të aplikojnë nëpër financim në bankat komerciale për kredi deri në 10 mijë euro me maturitet deri në 24 muaj.
- Pas aprovimit të financimit, FKGK do të ofrojë garanci deri në 50% të shumës së kredituar kurse Qeveria mbulon 30% shtesë (në total 80%) të shumës së kredituar.
- Norma e interesit subvencionohet 50% për këtë kategori.
- Shoqëritë tregtare aplikojnë për financim në bankat komerciale për kredi me afat kthimi deri më **31 Dhjetor 2020**.
- Për këto kategori do të subvencionohet në total norma e interesit.

Jeni punëtor pa kontratë pune?



Përfito
nga



E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Pagesë prej **130€** për punëtorin e regjistruar për dy muajt pasues pas regjistrimit.

Kush përfiton?


- Shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku 1 vjeçare gjatë situatës të pandemisë.

Si të aplikoj?

- Punëdhënësi duhet të lidhë kontratë punësimi për periudhë jo më të vogël se **1 vit**.
- Punëdhënësi duhet të plotësojë dhe ngarkojë në sistemin elektronik EDI formularët dhe listën e dizajnuar nga ATK në www.atk-ks.org deri më **15 Maj 2020**
- Për plotësim të listës së punëtorëve, duhet bërë kategorizimi i statusit të punëtorëve ku në kolonën “Statusi” vendosen shkronjat përkatëse (A,B,C), ku në **kategorinë C** hyjnë punëtorët e rinj të cilët kompensohen me vlerë **130€**
- Kontrata duhet të jetë e nënshkruar pas datës së fillimit të pandemisë në Kosovë.
- Punëdhënësi duhet deklaroj të punësuarin në listën e pagesave mujore nga fillimi i kontratës.
- I punësuar duhet të ketë **llogari bankare** në njërin nga bankat e Kosovës.
- Përfituesit duhet të paguajnë të gjitha taksat dhe detyrimet në mënyrë që i punësuar të marr pagë **130€** neto.
- Për udhëzime të detajuara për aplikim kliko në:

[Kliko ketu](#)

Jeni i regjistruar si i papunë?



Përfito nga

MASA
15

E PAKOS
FISKALE
EMERGJENTE

Çka përfiton?

- Asistencë mujore prej **130€ për familje** për periudhën Prill, Maj, dhe Qershor 2020.

Kush përfiton?

- Familjet me kushte të rënda sociale e të lajmëruar si të papunë në institucionet kompetente dhe të cilët nuk janë përfitues të skemave sociale dhe pensionale të financuara nga buxheti i Kosovës
- Një përfaqësues i familjes deklarohet si përfitues i skemës
- Përfaqësuesi i familjes duhet të jetë i regjistruar si i papunë së Zyrat e Punësimit
 - o Qytetarët tashmë të regjistruar si të papunë dhe që kanë deklaratë të papunësisë nuk kanë nevojë të regjistrohen përsëri
 - o Qytetarët të cilët nuk janë të regjistruar si të papunë, duhet të regjistrohen në Agjencinë e Punësimit duke aplikuar online ose direkt në Zyrën e Punësimit
 - o Për të aplikuar online në Agjencinë e Punësimit kliko:

<https://apr.k.rks-gov.net>

Si të aplikoj?

- Përfaqësuesi i familjes duhet të bëjë aplikimin **online ose fizik** :
- Aplikimi online:
 - o Plotëso formularin elektronik
 - [Kliko ketu](#)
 - o Dërgo formularin e plotësuar dhe **kopjen e letërnjoftimit** në e-mail adresën pako pako15@rks-gov.net
- Aplikimi fizik:
 - o Bëhet përmes Qendrës për Punë Sociale të komunës përkatëse
 - o Plotëso dhe dorëzo formularin së bashku me **kopjen e letërnjoftimit** në Qendrën për Punë Sociale
- Aplikimi duhet të bëhet deri më **15 Maj 2020**

